



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo

<http://kk.rks-gov.net/istog/>



Komuna e Istogut  
Opština Istok  
Municipality of Istog

Tel: 038/200 438 14

---

## KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2026-2028

---

### P R O C E S V E R B A L

Nga dëgjimi publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028 mbajtur më: 10, 11, 12, 13 Qershor 2025, në 6 bashkësi lokale të komunës së Istog, filluar me punë në orare të ndryshme.

Në Dëgjim ishin të pranishëm:

1. Ilir Ferati, Kryetar;
2. Drejtor të drejtorive Komunale;
3. Ardon Arifaj, Zyra e Kryetarit
4. Liliana Frrokaj, Zyra e Kryetarit;
5. Alketa Bujupaj, Zyra e Kryetarit

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Kryetari i komunës, z. Ilir Ferati dhe Drejtoret e Drejtorive

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryetari i komunës, z. Ilir Ferati.

Kryetari i komunës, z. Ilir Ferati – përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje dhe hapi dëgjimin publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028 dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

### R E N D D I T E

1. Njoftimi për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028,
2. Pyetje dhe Përgjigje

Dëgjim publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026–2028  
(i mbajtur në bashkësitë lokale Rakosh, Saradran, Vrellë, Gurrakoc, Banjë dhe Istog)

Komuna e Istogut organizoi dëgjime publike në gjashtë bashkësi lokale me qëllim të prezantimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore për periudhën 2026–2028. Takimet u mbajtën në Rakosh, Saradran, Vrellë, Gurrakoc, Banjë dhe në qytetin e Istogut.

Në secilin takim, Kryetari i Komunës prezantoi qëllimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore dhe rëndësinë e saj për planifikimin financiar afatmesëm. U theksua se ky dokument shërben si bazë për hartimin e buxhetit vjetor dhe orientimin e investimeve.

Qytetarët e secilës bashkësi lokale patën mundësi të paraqesin nevojat dhe prioritetet e tyre specifike. Në Rakosh dhe Saradran u theksua nevoja për përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe kanalizimit. Në Vrellë dhe Gurrakoc u kërkuar më shumë investim në ndriçimin publik dhe hapësirat rekreative. Në Banjë u diskutua për turizmin dhe shfrytëzimin e resurseve natyrore, ndërsa në Istog u ngritën çështje që lidhen me zhvillimin urban.

Përfaqësuesit komunalë morën shënime për të gjitha kërkesat dhe theksuan se prioritetet do të vlerësohen në përputhje me mundësitë buxhetore dhe strategjitë zhvillimore të komunës.

Në përfundim, u vlerësua pozitivisht pjesëmarrja e qytetarëve dhe u theksua se dëgjimet publike janë mekanizëm i rëndësishëm për përfshirjen e komunitetit në vendimmarrje.

Procesmbajtës:  
Ardon Arifaj, Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave

